

# Komunat kundër zvogëlimit të buxhetit të tyre nga 10 në 8 për qind

Koha.net - Publikuar: 01.04.2013 - 09:00

Prishtinë, 1 prill – Rekomandimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) bërë Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave (MEF) për zvogëlimin e buxhetit të komunave nga 10 në 8 për qind ka nxitur drojën te drejtuesit komunalë të Kosovës, pasi që, sipas tyre, me këtë do të zvogëloheshin mundësitë edhe ashtu tepër të vogla zhvillimore. Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, ka thënë të dielën se marrja parasysh e një rekomandimi të tillë për zbritje 2 për qind e buxhetit për komunat do të krijonte kolaps në kuptimin e zhvillimit të komunave. “Një zbritje e tillë ndoshta nuk do të thotë shumë për Qeverinë, por për komunat veç e veç është humbje e madhe. Për një komunë me buxhet të vogël do të thotë humbje deri në 30 për qind e buxhetit”, ka thënë Ibrahim. Në të njëjtat valë, por shprehur pak më ndryshe, është edhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemaj Mustafa.



“Sa u përket granteve, komunat e kanë thënë disa herë fjalën e vet se nuk mund të mbijetojnë as me këtë nivel të granteve (granti i përgjithshëm dhe ai për shëndetësi e arsim)”, ka thënë Mustafa për të shtuar se Këshilli i Kryetarëve të AKK-së dhe Bordi i AKK-së kanë diskutuar gjatë në të gjitha përfaqësimet në Qeveri, por edhe FMN dhe se e ka mbrojtur me argumente qëndrimin që granti i përgjithshëm jo që nuk duhet të zvogëlohet, por do të duhej të rritej, sepse sipas tij “komunat janë në ngushtica të skajshme financiare”. Edhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, e ka vlerësuar si shumë të dëmshëm zvogëlimin eventual të buxhetit për komunat për 2 për qind. “Në kuadër të AKK-së jemi takuar me përfaqësuesit e FMN-së, të cilëve u kemi paraqitur argumentet tona se pse është i dëmshëm zvogëlimi i buxhetit për komunat”, ka thënë Leka, sipas të cilit një zbritje e tillë secilës komunë ia zbret buxhetin për 25 për qind. “FMN-ja këtë rekomandim e ka bërë mbase me qëllim që vetë komunat të krijojnë më shumë të hyra vetjake, mirëpo një gjë e tillë është duke na u vështirësuar, edhe pse secila komunë për çdo vit ka rritje të të hyrave deri në 5 për

qind”, është shprehur Lekaj.

Ai ka thënë se për të krijuar më shumë të hyra është problem, ndërsa e ka zënë ngoje Ligjin për ndërtime, i cili i ka dëmtuar në masë të madhe komunat në këtë plan. Lekaj konsideron se FMN-ja do t'i marrë parasysh këto elemente dhe nuk do të këmbëngulë në uljen e buxhetit për komunat.

Një shqetësim për zbritje të buxheteve komunale nga Qeveria e Kosovës e ka shfaqur edhe kryetari i Komunës së Graçanicës, Bojan Stojanović, porse një gjë e tillë e ka lidhur me krizën globale financiare. “Të gjithë po mundohemi për prosperitet dhe zhvillim më të hovshëm ekonomik, për çfarë janë të nevojshme mjete shtesë financiare, prandaj një vendim eventual i tillë nuk është i mirë”, ka thënë Stojanović. Megjithatë, siç është shprehur ai, të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm se në këtë krizë globale “jemi të detyruar ta shtrëngojmë rripin ngapak”. Stojanović ka theksuar se qëndrimi në lidhje me këtë çështje do të jetë i përbashkët me të gjithë kryetarët e komunave të Kosovës. Në një qëndrim të AKK-së, ndërkaq, kërkohet që të respektohet Karta Evropiane mbi Vetëqeverisje Lokale, për të cilën thuhet se nuk është duke u respektuar. Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahim, duke paraqitur qëndrimin e këtij organizimi ka theksuar se një kartë e tillë u jep autonomi komunave për të vendosur mbi strukturën e tyre buxhetore, mbi vendimmarrjet financiare dhe mbi strukturën e stafit. Ai thekson se komunat kanë ngritur për 12.16% të hyrat vetjake në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Me këtë, sipas tij, bien poshtë deklaratat e nivelit qendror se komunat nuk kanë ngritje të të hyrave vetjake.

Në këtë rrafsh, sipas Ibrahimit, Bordi i AKK-së duhet të jetë në Komisionin e granteve jo vetëm me 4 kryetarë komunash, që përcaktohen si në lotari, por në bazë të përfaqësimit më komplet, më politik dhe etnik. Ky asociacion ka afruar edhe propozime për ndarje të buxhetit, një nga të cilat është se investimet kapitale nga ministritë e linjës të shpërndahen duke respektuar formulën e granteve, duke u paraprirë nga studimet e fizibilitetit, në bazë të nevojave të komunave dhe kost-benefiti i investimeve dhe në forma më të përshtatshme. Një nga zgjidhjet më të përshtatshme, sipas drejtorit ekzekutiv të

AKK-së, Ibrahim, është krijimi i një fondi për komunat, në të cilin do të derdheshin mjetet financiare, ndërsa komunat do të konkurrojnë për t'i fituar ato nëpërmjet projekteve. "AKK-ja do të duhej të ishte gjithsesi në Komisionin vlerësues", është shprehur ai. Shqetësimi më i madh i AKK-së për zvogëlimin e buxhetit është tashti kur Ligji për Financat Lokale (LFL) është në procedurë të ndryshimit e ku edhe AKK-ja është pjesë aktive e Grupit Punues. Këshilltari i u.d. të ministrit të Financave, Menderes Ibra, edhe pse e ka pranuar se një rekomandim i tillë ekziston nga FMN-ja që nga viti 2011, në këtë ministri ende po vepron pa ndryshime.

"Për momentin planet i kemi të veprojme ashtu siç kemi vepruar deri tashti", ka thënë Ibra, të dielën. Sidoqoftë, edhe nëse nuk merret për bazë rekomandimi në fjalë i FMN-së për ulje të buxhetit për komunat nga 10 në 8 për qind, burimet brenda Qeverisë kanë theksuar se më 2014 buxheti për komunat do të ndahet në bazë të numrit të banorëve. E në bazë të regjistrimit të popullsisë më 2011, në shumicën e komunave të Kosovës ka pasur më pak banorë se sa prezantoheshin më parë.

Vetëm në Komunën e Prishtinës janë regjistruar më shumë se 100 mijë banorë më pak, ani pse zyrtarët e saj vazhdojnë ta kontestojnë atë regjistrim.